

VENDIM
Nr. 33, datë 11.5.2018

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË PËR
SHOQËRINË UJËSJELLËS
GRAMSH SHA**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 27.4.2018, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, të kërkesës së Ujësllës Gramsh sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit furnizimit me ujë të pijshëm për zonat e reja që i janë bashkuar Ujësllës Gramsh, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

VËREN SE:

- Ujësllës Gramsh sh.a. ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU-së, me shkresën nr. 677, datë 7.12.2017, me lëndë "Kërkesë për vendosje tarifë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm, si dhe tarifë fikse për zonat e reja të shërbimit që janë transferuar pranë shoqërisë sonë, referuar VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016".

- Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 8, datë 16.2.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësllës Gramsh sh.a., e cila ka propozuar të aplikojë për zonat e reja të njëjtin nivel tarifor që aplikon në zonën ekzistuese.

- ERRU-ja e konsideron nevojën e vendosjes së tarifave për zonat e reja si një domosdoshmëri në zbatim të akteve ligjore dhe të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

- ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike, ka kërkuar nga operatori informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

- ERRU-ja, në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë kostot totale për shërbimin e ofruar, në pamundësi të shoqërisë për t'i ndarë ato sipas zonave.

- Operatori ka propozuar kosto më të larta, për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 në vlerën prej 4.8 milionë lekësh, ndërsa të ardhurat janë parashikuar të rriten me rreth 2 milionë lekë. Prandaj nivelet e mbulimit të kostove të O&M dhe kostot totale janë parashikuar të pësojnë një rënie krahasuar me ato të vitit paraardhës.

- ERRU-ja ka gjykuar se shoqëria për vitin 2018 duhet të mbajë kostot në nivelin e vitit 2017, pra rreth 37.8 milionë lekë, sepse edhe gjatë vitit 2017 praktikisht shoqëria ka mbuluar kostot edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit (zona rurale).

- ERRU-ja gjykon se ka akoma rezerva në rritjen e të ardhurave duke qenë se mund të rritet niveli i faturimit, nga evidentimi i lidhjeve të paligjshme në lidhjen e kontratave respektive, gjithashtu, gjykon se mund të gjenden mekanizma të përshtatshëm për mbledhjen e borxheve.

- ERRU-ja konstaton se shoqëria Ujësllës Gramsh sh.a. ka ende nevojë për subvencione për të mbuluar kostot totale.

- ERRU-ja, bazuar në informacionin e gjendjes së aseteve të shoqërisë, konstaton se shoqëria ka nevojë për investime emergjente dhe afatmesme, pasi rrjeti është shumë i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.

- Nga analiza e të dhënave, rezulton që tarifat e propozuara nga shoqëria janë në përputhje të plotë me parimin e rregullatorit mbi përballueshmërinë që fatura e llogaritur me tarifat e reja të mos jetë më shumë se 5% e shpenzimeve mesatare mujore të një familjeje sipas të dhënave të INSTAT-it.

- Nisur nga analiza e treguesve të performancës, ERRU-ja konstaton se nga zgjerimi i zonës së shërbimeve është e paevitueshme që disa tregues të pësojnë rënie për një periudhë transitore, jo më shumë se dyvjeçare.

- Uji pa të ardhura parashikohet që në vitin 2018 të përmirësohet me -2.8%, kjo kryesisht do të vijë

nga vendosja e matësve në burim e depo, prerja e lidhjeve të paligjshme, instalimi i matësve individualë, si dhe nga investimet që janë parashikuar të bëhen në rrjetin e ujësjellësit.

- Niveli i matjes është i ulët në nivelin 53%. Shoqëria raporton se e konsideron prioritet dhe aktualisht është në proces të instalimit të ujëmatësve. Shoqëria, brenda 4-mujorit 2018, ka instaluar pothuajse të gjithë matësit në klientët jofamiljarë dhe niveli i matjes është parashikuar të jetë 56%. Kjo do ta bëjë klientin të paguajë ujin që konsumon.

- Norma e arkëtimit aktualisht është rreth 86%, shoqëria ka bërë një plan masash për vjeljen e debive të prapambetura me qëllim që ky tregues për vitin 2018 të jetë 90%.

- Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë aktualisht është 84%, por legalizimi i lidhjeve të paligjshme dhe evidentimi i saktë i klientëve do ta përmirësojë me 2% këtë tregues.

- Mesatarisht shoqëria furnizon me ujë 20 orë në ditë. Ka zona si Bashkia Gramsh dhe disa fshatra që marrin ujë 24 orë. Për vitin 2018 ky tregues do të rritet me 1 orë më tepër furnizim me ujë të pijshëm për gjithë zonën e shërbimit.

- Treguesi staf/1000 lidhje është 7.8 punonjës. Për vitin 2018 ky tregues do të ulët me 0.4 punonjës. Rënia e këtij treguesi vjen për shkak të rënies së numrit të punonjësve në përputhje me nevojat reale të menaxhimit korrekt të shërbimit të furnizimit me ujë.

- ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e mësipërm të performancës, si dhe në zbatim të rekomandimeve të mëposhtme:

- shoqëria duhet të punojë fort në drejtim të evidentimit të saktë të të gjithë klientëve në zonën e shërbimit për të eliminuar praninë e konsumatorëve me lidhje ilegale;

- shoqëria duhet ta ketë prioritet instalimin e matësve në burim dhe në depot e ujit, si dhe hartimin e bilanceve të sakta të ujit për të përcaktuar saktësisht humbjet administrative dhe ato teknike;

- shoqëria duhet të hartojë, brenda vitit, Planin e Biznesit 5-vjeçar për të gjithë zonën e shërbimit;

- shoqëria duhet të përfundojë brenda një afati 2-vjeçar instalimin e matësve individualë për konsumatorët familjarë;

- shoqëria duhet të detyrojë të gjithë konsumatorët privatë dhe institucionalë që të pajisen me matës brenda vitit 2018;

- shoqëria duhet të hartojë një plan masash të detajuar agresiv për vjeljen e debive të prapambetura dhe në përputhje me kërkesat e reformës së ujit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Gramsh sh.a., si më poshtë:

Kategoria	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse shërbimi
a. Për shërbimin e furnizimit me ujë	lekë/m ³	lekë/muaj
1. Konsumator familjar	32	60
2. Konsumator publik	90	150
3. Konsumator privat	90	180

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018, të jenë:

Treguesit e performancës	Viti 2017 (realizimi)	Viti 2018 (objektivi)
Mbulimi me ujë	84%	86%
Niveli i matjes	53%	56%
Uji pa të ardhura	41.8%	39%
Norma e arkëtimit	86%	90%
Orët e furnizimit me ujë	20 orë	21 orë
Staf për 1000 lidhje uji	7.8 punonjës	8.2 punonjës
Uji pa të ardhura	41.8%	39%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës Gramsh sh.a. do të jetë 0,6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.6.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi nr. 54, datë 30.12.2016, “Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë U Gramsh sh.a., shfuqizohet.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani